

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa kryetare e kolegjit, Avdi Dinaj dhe Nebojša Boričić anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të pandehurit N. K., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizata apo grupe individualisht, në çfarëdo forme të konfliktit të armatosur jashtë territorit të Kosovës, nga neni 3 par.4 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit – Ligji nr.05/L-002 dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit N. K., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.58/2016 të datës 26.08.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1461/2016 të datës 08.09.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.10.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit N. K., paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë – Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.58/2016 të datës 26.08.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN1.nr.1461/2016 të datës 08.09.2016.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, me aktvendimin PP.nr.58/2016 të datës 26.08.2016, të pandehurit N. K., për shkak dyshimit të bazuar se ka kryer

veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizata apo grupe individualisht, në çfarëdo forme të konfliktit të armatosur jashtë territorit të Kosovës, nga neni 3 par.4 të Ligjit për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit – Ligji nr.05/L-002 dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPK, ia ka vazhduar masën e paraburgimit në edhe për 2 (dy) muaj e cila do të llogaritet nga data 27.08.2016 deri me 28.10.2016. Masa e paraburgimit iu është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2, pika 1.2.1, 1.2.2, 1.2.3 të KPPK-së.

Vendimi i Gjykatës së Apelit

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur mbrojtësi i të pandehurit, mirëpo Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN1.nr.1461/2016 të datës 08.09.2016, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën dhe e ka vërtetuar aktvendimin e ankimuar.

Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit N. K. av. I. S., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale nga neni 384 par.2 nënpar.2 pika 1 lidhur me nenin 185 dhe 192 par.2 të KPPK, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës t'i anulojë aktvendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe ato të shkallës së dytë dhe masën e paraburgimit ta zëvendësojë me masën e arrestit shtëpiak.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi kryesisht thekson se aktvendimet e atakuara janë marrë me një varg shkeljesh të KPPK, ngase në të dy aktvendimet nuk është shënuar ndonjë arsye apo ndonjë fakt vendimtarë por vetëm një supozim lidhur me mundësin e arratisjes, ndikimit në dëshmitar dhe përsëritjes së veprës penale, se të dy aktvendimet janë të pakuptueshme, kontradiktore me vetvete dhe të paqarta, se i pandehuri asnjëherë nuk ka rënë ndesh me ligjin, është person familjar dhe se çdo here do t'i përgjigjet ftesës së gjykatës.

Opinionimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.48/16 të datës 07.10.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të pandehurit N. K. të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate pretendimet e mësipërme janë të pabazuara ngase në këtë çështje penalo juridike nga shkresat e lëndës, raportet e policisë për zbatimin e masave të fshehta, të autorizuar nga gjykata, fotodokumentacioni, procesverbali mbi konfiskimin e armës dhe mjeteve kompjuterike si dhe provat tjera të mbledhura gjerr më tani rezulton se ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri është kryrës i veprave penale, me çka janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 187 par.1 nën par.1.1 të KPPK për vazhdimin e paraburgimit, kurse a do të argumentohen këto fakte do të vlerësohet në fazat e mëtejme të procedurës penale.

Kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.1 të KPPK ngase me lëshimin e të pandehurit në liri ekziston rreziku i fshehjes apo arratisjes me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale duke pasur parasysh faktin se këto vepra penale janë të natyrës rëndë, e nëse i pandehuri shpallet fajtor, parashihen dënime mjaft të larta, ashtu që në këtë mënyrë do të ishte i paaritshëm për organet e ndjekjes dhe do ta pamundësonte zhvillimin e rregullt të procedurës penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.2 të KPPK-së, sepse po të gjendej i pandehuri në liri ekziston rreziku i asgjësimit, fshehjes apo ndryshimit të provave të veprës penale, ndikimit në dëshmitarët emrat e të cilëve nuk mund të publikohen për shkaqe të sigurisë së jetës së tyre, si dhe nga

kallëzimi penal rezulton se në bazë të informacioneve të policisë dhe në bazë të transkripteve të përgjimit të telefonave në këtë çështje penale janë të përfshirë edhe persona të tjerë ashtu që mund të ndikojë edhe tek të pandehurit tjerë të mundshëm që kanë bashkëpunuar me të, dhe me qenë se hetimet ende nuk kanë përfunduar, mund ta pengonte rrjedhën normale të procedurës penale.

Gjithashtu kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe konform nenit 187 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK-së duke pasur parasysh peshën e rëndë të veprës penale, mënyrën profesionale të kryerjes së veprës penale, fakti se i pandehuri në periudhën kohore gjatë vitit 2014, 2015 dhe gjatë vitit 2016 ka transmetuar përmes internetit në një radio me emrin “...” për zhvillimin dhe propagandimin e aktiviteteve të grupeve të ndryshme terroriste, me qëllim që të nxisë urrejtjen dhe bën thirrje tek të rinjtë kosovar për të ju bashkuar këtyre organizatave, lë të besohet se me lëshuarjen e të pandehurit në liri mund të vijë deri te përsëritja e veprës penale.

Andaj nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo Gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 173 të KPPK janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga sa u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.250/16 datë 10.10.2016.

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa